



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



RAPORT VJETOR **2023**

KUSH JEMI

Partnerët Shqipëri është një OJF shqiptare e pavarur, e themeluar në vitin 2001, që mbështet shoqërinë civile dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndër-sektorial me qëllim forcimin e institucioneve demokratike dhe avancimin e zhvillimit ekonomik.

Partnerët Shqipëri është anëtare e Kodit të Standardeve të Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri, dhe luan rolin e Sekretariatit të Kodit përmes Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.

Partnerët Shqipëri është anëtare e Partners Network, një partneritet i 19 organizatave të pavarura në Evropë, Amerikën Veriore dhe Jugore, Afrikë e Lindjen e Mesme, të cilat punojnë për një ndryshim paqësor e demokratik.

Partnerët Shqipëri është anëtare edhe e disa rrjeteve të tjera globale, rajonale dhe evropiane si BCSDN, ECAS, DIESIS, ANNA LINDH, WINGS, Alliance for Peacebuilding, CHANCE – Civil Hub Against organised Crime in Europe, etj.

www.partnersalbania.org



RAPORT VJETOR 2023

PËRMBAJTJA

Fjalë përshëndetëse	4
Fakte kryesore nga 2023	6-7
Programet tona	10
Shërbime me pagesë	46
Puna jonë në media	47
Projektet	48
Mbështetësit tanë kryesorë	49
Financat	50



FJALA PËRSHËNDETËSE



Kam kënaqësinë të ndaj me ju Raportin tonë Vjetor 2023. Ka qenë një vit rritjeje, të mësuarit dhe bashkëpunimi më të madh në nivel lokal, rajonal dhe global, ku kemi dëshmuar fuqinë kolektive të individëve dhe organizatave që punojnë drejt një vizioni të përbashkët.

Përpjekjet tona këtë vit janë përqendruar në investimin në njerëz, organizata dhe ide që mund të sjellin një ndryshim afatgjatë. Nga promovimi i sipërmarrjes së qëndrueshme tek ofrimi i mbështetjes thelbësore për organizatat jo-fitimprurëse, kemi qenë të vendosur në angazhimin tonë për të ndërtuar komunitete të qëndrueshme. Puna jonë, e bazuar në bashkëpunim, ka sjellë përpjekje të rëndësishme në fusha kyçe si qeverisja, transparenca, inovacioni social dhe zhvillimi i filantropisë.

Këtë vit kemi punuar ngushtë brenda kornizës së agjendës së integritit të Shqipërisë në BE, duke siguruar që shoqëria civile të luajë një rol thelbësor në mbështetjen e këtij objekti të rëndësishëm kombëtar. Përpjekjet tona në negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në vitin 2023 ka forcuar nevojën për përputhshmëri më të madhe me vlerat evropiane të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes me pjesëmarrje. Përmes nismave tona, Partnerët Shqipëri ka kontribuar në mënyrë aktive për këtë qëllim, duke advokuar për një shoqëri civile më të angazhuar dhe të fuqizuar që mund të mbajë përgjegjëse institucionet dhe të nxisë qeverisjen demokratike.

Kemi vijuar punën për zhvillimin e filantropisë si një mjet për të forcuar nismat e drejtuara nga komunitetet. Përmes përpjekjeve tona filantropike, kemi mbështetur projekte lokale që adresojnë nevoja urgjente shoqërore dhe nxisin solidaritetin. Nismat tona pioniere të financimit përmes crowdfunding kanë fuqizuar komunitetet lokale duke mobilizuar burime nga donatorët individualë dhe korporativë për të mbështetur projekte që variojnë nga arsimit dhe ruajtja e mjedisit deri tek përfshirja sociale. Kjo punë nënvizon rëndësinë e një kulture të gjallë dhe të angazhuar filantropike për të adresuar sfidat e Shqipërisë dhe për të shfrytëzuar mundësitë e saj.

Kemi pasur privilegjin të mbështesim shumë nisma që jo vetëm sjellin ndryshime pozitive, por gjithashtu krijojnë hapësira për dialog dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse. Përmes programeve tona të ndërtimit të kapaciteteve, shërbimeve të mbështetjes ligjore apo përpjekjeve tona advokuese, kemi dëshmuar përkushtimin dhe vendosmërinë e aktorëve të shoqërisë civile për të përmirësuar komunitetet e tyre. Ky është ndikimi i vërtetë i punës sonë: mundësimi i aktorëve në sektorët që synojmë për të pasur sukses dhe për të bërë ndryshim.

Puna jonë në promovimin e sipërmarrjes dhe inovacionit social ka vijuar të frymëzojë, ndërsa kemi mbështetur sipërmarrje të fokusuara në qëndrueshmëri, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e komunitetit. Këto përpjekje janë një tregues i potencialit që ekziston në vendin tonë për të krijuar ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme, veçanërisht ndërsa Shqipëria vijon të afrohet më shumë me aspiratat e saj të integritit evropian. Vlerat e gjithëpërfshirjes, qëndrueshmërisë dhe inovacionit janë në qendër të vizionit të BE-së, dhe jemi krenarë që shohim të njëjtat vlera të pasqyruara në punën e sektorit të shoqërisë civile dhe të sipërmarrjes shqiptare.

Ndërsa shohim përpara, mbetemi thellësisht të angazhuar për të avancuar vlerat që drejtojnë misionin tonë: përfshirje, bashkëpunim dhe qëndrueshmëri. Jemi mirënjohës për besimin e vendosur tek ne nga partnerët dhe mbështetësit tanë, të cilët kanë luajtur një rol thelbësor në arritjen e këtyre rezultateve. Së bashku, do të vazhdojmë të promovojmë rolin e shoqërisë civile si një shtyllë kryesore në ndërtimin e një të ardhmeje më të drejtë dhe të qëndrueshme për të gjithë, në përputhje të plotë me aspiratat e integritit evropian të Shqipërisë.

Duke parë përpara në vitin 2024, ne njohim nevojën për të ndërtuar mbi këtë moment me një qasje më të përqendruar dhe të qëllimshme. Strategjia jonë për vitin e ardhshëm do të fokusohet në mënyrë të theksuar në matjen e ndikimit të vërtetë të punës sonë duke forcuar proceset që mbështesin përpjekjet tona. Me mbështetjen e vazhdueshme të zgjidhjeve dixhitale, synojmë të përmirësojmë mënyrën se si gjurmojmë, vlerësojmë dhe shkallëzojmë rezultatet e programeve tona. Ky investim do të na lejojë të përsosim qasjen tonë dhe të sigurojmë që çdo veprim që ndërmarrim të jetë ngushtësisht në përputhje me nevojat dhe aspiratat e komuniteteve të cilave u shërbejmë, si dhe integritimin më të gjerë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Jam thellësisht mirënjohëse për besimin dhe mbështetjen që kemi marrë nga partnerët dhe përfituesit tanë. Së bashku, do të vazhdojmë të sfidojmë kufijtë, të nxisim inovacionin dhe të ndërtojmë një shoqëri civile më të fortë dhe më të qëndrueshme që luan një rol vendimtar në të ardhmen e Shqipërisë brenda Bashkimit Evropian.

Juliana Hoxha
Drejtoreshë



FAKTE NGA PUNA JONË NË 2023

Aktivitetet dhe pjesëmarrësit

483 DITË AKTIVITET



458 EVENTE

- » Trajnime
- » Mentorime
- » Sesione Informuese
- » Evente rrjetëzimi
- » Konferenca ndërkombëtare & evente publike
- » Konkurse / Pitching event
- » Evente dhurimi Live
- » Tryeza diskutimi
- » Vizita studimore

3259 PJESËMARRËS TË DREJTPËRDREJTË


Pjesëmarrja gjinore



F 70%
M 30%

62 LEKTORË & EKSPERTË TË ANGAZHUAR

Ndjekësit dhe angazhimi në rrjetet sociale



» **30K** Ndjekës

2K më shumë në vitin 2023

» **66K** Vizita

94% më shumë në vitin 2023

» **500K** Audiencia e arritur

25% më shumë në vitin 2023

» **228%** Më shumë angazhim në përmbajtje krahasuar me 2022

Publikimet dhe daljet në media



42 PUBLIKIME

- » Studime
- » Raporte
- » Revista
- » Broshura
- » Buletine informative

20 DALJE NË MEDIA



Projektet dhe partnerët




18 PROJEKTE

12 DONATORË

25 PARTNERË ZBATUES

Përfaqësimi



△ Kombëtar

△ Rajonal

△ Global

Rrjeti "Partners"
Alliance for Peace-building

Rrjeti DIESIS
Rrjeti ECAS

Rrjeti Ballkanik për
Zhvillimin e Shoqërisë
Civile

Rrjeti WINGS

Rrjeti ANNA LINDH

CSO Partnership
for Effectiveness
Development

CHANCE – Civil Hub
Against organised
Crime in Europe

FUSHAT TONA PROGRAMATIKE

- ▶ Mjedisi mundësues dhe zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë civile
- ▶ Sipërmarrja dhe Inovacioni Social
- ▶ Aktiviteti filantropik dhe infrastruktura mbështetëse
- ▶ Qeverisje me pjesëmarrje transparente dhe e përgjegjshme

PËRFITUESIT TANË

- ▶ Shoqëria civile
- ▶ Sipërmarrësit socialë dhe novatorë
- ▶ Institucionet shtetërore dhe politikëbërësit

ÇFARË OFROJMË

- ▶ Ndërtim dhe fuqizim kapacitetesh
- ▶ Mbështetje financiare
- ▶ Advokim dhe punë kërkimore



FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË SHOQËRISË CIVILE



Eventi i rrjetëzimit , Java e Shoqërisë Civile 2023, 2 qershor 2023, Elbasan



NDËRTIM KAPACITETESH

7

PROGRAME

- Akademia e OJF-ve
- Manaxhimi i Granteve
- Gjenerimi i të Ardhurave, Ngritja e Shërbimeve me Pagesë
- Shkëmbimi i OJF-ve
- Adaptueshmëria Organizative (Resiliency +)
- EU Aquis - Angazhimi dhe Roli i OSHC-ve në Procesin e Integritit të Vendit në BE
- Programe Trajnimi Sipas Nevojave

22

TEMA

- Adaptueshmëria organizative (Resiliency +)
- Advokacia Digjitale - përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve digjitale
- Advokasia e bazuar në fakte
- Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe roli i OJF-ve në këtë proces
- Diversifikimi i fondeve përmes shërbimeve me pagesë
- Fushatat Crowdfunding
- Komunikimi Strategjik
- Kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve në Shqipëri
- Lobimi

- Manaxhimi financiar: Buxhetimi dhe kontabiliteti, detyrimet dhe raportimet në shtet, procedura e rimbursimit të TVSH
- Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme
- Manaxhimi i granteve
- Mobilizimi i mbështetësve, krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve
- Ngritja e fondeve - sigurimi i mbështetjes nga grantet, fondet publike, filantropia dhe puna me sektorin privat
- Planifikimi strategjik
- Qeverisja me pjesëmarrje
- Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së
- Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative

45

DITË TRAINIMI

310

SEANCA MENTORIMI

2

PROGRAME VIZITASH STUDIMORE

596

PËRFITUES

Pjesëmarrja gjinore



Përfitues jashtë kryeqytetit



SHËRBIME MBËSHTETËSE, INFORMIM DHE RRJETËZIM, ASISTENCË PËR RRJETET

573

KËRKESA PËR INFORMACION NGA OJF-TË , TË ADRESUARA

270

OJF të asistuar

2

EVENTË KOMBËTARE RRJETËZIMI

160

Pjesëmarrës

27

SESIONE INFORMUESE RAJONALE

142

OJF, aktivistë, të rinj, studentë etj. të informuar rreth çështjeve lidhur me zhvillimin e shoqërisë civile

5

RRJETE TË ASISTUARA

6

Nisma advokuese të ndërmarra



DËSHMI TË PËRFITUESVE TANË



Në programin katër-ditor të Shkëmbimit të OJF-ve, vizitua disa institucione të pushtetit qendror dhe shoqërisë civile, ku mësuam teknika mbi advokimin, manaxhimin, administrimin dhe monitorimin e nismave tona. Këto teknika janë shumë të suksesshme për t'i implementuar në komunitetin tonë. Këtë program e rekomandoj për çdo organizatë, si një mundësi shumë të mirë për të zgjeruar rrjetin e saj, dhe për të mësuar mbi praktika të suksesshme të adresimit të nevojave të komunitetit. Përmes tij organizata jonë, falë njohjes dhe me Rrjetin "AWEN", u përzgjedh si organizatë fituese e një skeme financimi mbi parandalimin e diskriminimit direkt dhe indirekt të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Mirditë. I falenderoj për mundësinë dhe e rekomandoj këtë program për çdo organizatë që ka dëshirë dhe vullnet për të sjellë zhvillim dhe ndryshim pozitiv në komunitetin e saj.

Arbërora Leti

Themeluese e organizatës "Opportunity, Balance & Overcoming", Rrëshen



I shoh me shumë vlerë organizime të tilla ndaj e pranova ftesën e Partnerëve Shqipëri. "Programi i Shkëmbimit të OJF-ve" shërbeu si medium diskutimi me një fokus të veçantë në të drejtat e njeriut dhe përpjekjet kundër diskriminimit. Përmes përpjekjeve bashkëpunuese dhe përvajave të ndara, u mundësua një dialog dhe mjedis mbështetës për organizatat që të thellojnë kuptimin e tyre për parimet e të drejtave të njeriut dhe strategjitë për të luftuar diskriminimin në mënyrë efektive. Ju uroj suksese organizatave në punën e tyre dhe shpresoj të përdoren sa më shumë mekanizmat."

Dr. Robert Gajda

Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Akademia e OJF-ve ka qenë një nga përvojat më të bukura gjatë rrugëtimit tim në shoqërinë civile, duke kontribuar në rritjen e njohurive dhe lidhjeve njerëzore. Informacionet dhe njohuritë e reja që mora për organizatën time na ndihmuan në rritje dhe më dhanë një shtysë për të vazhduar me më shumë pasion punën si drejtues i një organizate lokale në Bulqizë. Të gjithë duhet të jenë pjesë e Akademisë së OJF-ve, pasi jo vetëm rritesh profesionalisht, por përfiton si organizata, ashtu edhe shoqëria civile në tërësi.

Riges Beqiri

Shoqata e Natyrës dhe Turizmit Bulqizë






ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE



Komente dhe rekomandime drejtuar Agjencisë së Inteligjencës Financiare për raportin e Vlerësimit Kombëtar të Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Shqipëri



Letër e Partnerët Shqipëri drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi Vendimin nr. 445 "Për Miratimin e Formularëve Standard të Regjistrimit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse"



Kontribut për Paketën e Dokumentit të Veprimit Shumë Vende IPA III 2024, si pjesë e Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile



Partnerët Shqipëri, pjesë e grupit rajonal të punës për rishikimin e Paketës Shpjeguese të Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile



Rekomandime për Udhëzimet e DG NEAR për mbështetjen e BE për shoqërinë civile në rajonin e zgjerimit 2021-2027



Kontribut në Dokumentin Rajonal të Politikave: Rregullimet për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit dhe Implikimet mbi OSHC-të në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi



Kontribut i dhënë në rishikimin e Rekomandimit 8 dhe Publikimin e Praktikave më të Mira të FATF-së



Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2022



Udhëzues praktik për të parandaluar abuzimin e mundshëm të Organizatave Jofitimprurëse (OJF) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit



Raporti i "Vlerësimit të kapaciteteve dhe nevojave të OSHC-ve në Shqipëri" për vitin 2023



Dëftesat mbi Progresin dhe Nivelin e Përgatitjes së Shqipërisë drejt Anëtarësimit në Bashkimin Evropian

- Vlerësimi i Kapitullit 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)
- Vlerësimi i Kapitullit 24 (Drejtësia, Liria, Siguria)
- Vlerësimi i Kriterit Politik

Kontribut në agjendën rajonale lidhur me mjedisin mundësues për shoqërinë civile - 15 aktivitete publike ku Partnerët Shqipëri ka qenë prezente në panele diskutimi si folës.



Forumi i BE-së për Shoqërinë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi 2023 mbajtur më 31 maj – 1 qershor 2023, në Podgoricë, Mal i Zi, me pjesëmarrjen e institucioneve të Bashimit Evropian që punojnë për Zgjerimin, organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.



Konferenca rajonale e OSBE-së nën Kryesinë e Maqedonisë së Veriut, mbajtur në 31 tetor 2023 në Shkup, me fokus luftën ndaj korrupsionit, pastrimit të parave, dhe lehtësimin e përpjekjeve për rikuperimin e aseteve të konfiskuara në Evropën Juglindore.



Eventi advokues "Pas në rrenjë të Demokracisë - Fuqizimi i shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" zhvilluar në Bruksel nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkan, lidhur me rolin e veçantë të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi në procesin e zgjerimit.



Takim midis anëtarëve të ekipit negociator për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile pas përfundimit të shqyrtimit analitik të grupit të parë të kapitujve, duke përfshirë gjyqësorin dhe të drejtat themelore, me Komisionin Evropian.



Forumi i 9-të i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga Komiteti Ekonomik Social Evropian më 19-20 tetor 2023, në Selanik, Greqi, ku u diskutuan disa çështje kryesore si statusi i demokracisë në Evropën Juglindore, 2023 si Viti Evropian i Aftësive, dhe roli i shoqërisë civile në avancimin e Agjendës së Gjelbër dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Evropën Juglindore.



Diskutim i thelluar mbi Rekomandimin 8, zhvilluar nga Koalicioni Global i OJF-ve i Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), si pjesë e Forumit Konsultativ me Sektorin Privat të FATF mbajtur në Vjenë në 8-9 maj, 2023.



Konferenca e parë globale "Rreziqet dhe Pasojat: E ardhmja e Rekomandimit 8 të FATF për Integritetin Financiar dhe për Shoqërinë Civile", zhvilluar në Bon, Gjermani, në 26-27 shtator 2023, nën organizimin e përbashkët të EU AML/CFT Global Facility, programi i Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH 'Combating Illicit Financial Flows,' dhe Koalicioni Global i OJF-ve për FATF.



Takimi i Grupit të Partnerëve Mesdhetar për Bashkëpunim të OSBE-së, zhvilluar në Vjenë në maj 2023, me fokus luftën kundër korrupsionit përmes konfiskimit të aseteve.



Takim i vendeve pjesëmarrëse në Partneritetin për Zhvillimin Efektiv (CPDE), mbajtur në mars 2023 në Paris, ku u diskutuan plani i ri strategjik i organizatës, drejt rezultateve dhe impakti më të lartë.



Eventi People-to-People "Viti Evropian i Aftësive: Aftësi për Organizatat Jofitimprurëse në Ballkanin Perëndimor (BP) dhe Turqi" mbajtur në Tiranë në 21-22 nëntor 2023, organizuar nga TACSO 3.



Konferenca "Vullnetarizmi në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi - Agjenda për Veprim" – mbajtur në Tiranë më 28-29 mars 2023, e organizuar nga TACSO 3.



Takimi rajonal People-to-People "Procesi i Negociatave për Anëtarësim në BE: Shkëmbim Eksperiencash midis OSHC-ve nga Mali i Zi dhe Serbia, me OSHC-të nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut" mbajtur në Tiranë, më 30-31 mars, organizuar nga TACSO 3.



MBËSHTETJE FINANCIARE

Përgjatë 8 viteve të zbatimit, projekti LevizAlbania mbështeti me qindra nisma të cilat angazhuan direkt dhe indirekt qytetarë, të rinj e të reja, të moshuar, komunitete në vështirësi, grupe të marginalizuara, individë të gatshëm për të kontribuar në komunitet, të mobilizuar dhe të frymëzuar për të ndryshuar për mirë qeverisjen vendore, rritur përgjegjshmërinë e të zgjedhurve vendor, transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen në vendimarrje.



AKTIVIZMI

LEVIZ

38,491

QYTETARË
TË PËRFSHIRË

309

PROJEKTE
TË MBËSHTETURA

61

BASHKI
TË MBULUARA

LEVIZ
Albania
Local Democracy in Action



9 THIRRJE PËR
APLIKIME



23 PROJEKTE
REAGIMI I SHPEJTË



12 PROJEKTE
STRATEGJIKE

DEDIKUAR

DEMOKRACISË

VENDORE



FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË SIPËRMARRËSVE SOCIALE DHE NOVATORË





NDËRTIM KAPACITETESH

3 PROGRAME
PËR NDËRTIMIN E
KAPACITETEVE

- Manaxhimi i granteve, manaxhimi financiar, dhe shkëmbimi i përvojave për përfituesit e granteve të TWIST
- Përgatitja e planit të biznesit dhe marketingu e promovimi për aplikantët e interesuar në konkursin e bizneseve të gjelbërta
- Wises4youth - program për ndërtimin e kapaciteteve të sipërmarrësve të rinj socialë

114 PËRFITUES

Pjesëmarrja gjinore



Përfitues jashtë kryeqytetit



8 DITË TRAJNIMI

6 VIZITA STUDIMORE

- Vizitë studimore në Itali rreth ripërdorimit social të pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar (në kuadër të TWIST)
- 5 vizita studimore të sipërmarrësve të rinj në 5 vende të Ballkanit, përfshirë Shqipërinë (në kuadër të programit Wises4Youth)

INFORMIM DHE RRJETËZIM

13 SESIONE INFORMUESE RAJONALE

693 Sipërmarrës, startupe dhe individë me ide biznesi të informuar rreth Konkursit të Ideve të Gjelbërta dhe Thirrjes për Propozime të Challenge Fund

1 PANAIR DHE EVENT RRJETËZIMI

20 Sipërmarrje të gjelbërta të mbështetura nga Partnerët Shqipëri u promovuan në panairin publik "The Future is Green" organizuar në kuadër të Javës së Gjelbër Evropiane 2023



PER NJE TREG PUNE NE DOBI TE RINISE SHQIPTARE

RisiAlbania është një projekt inovativ, i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC, në partneritet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe që zbatohet nga Helvetas dhe Partnerët Shqipëri. Projekti synon të ofrojë më shumë mundësi punësimi për të rinjtë dhe të rejtat në Shqipëri, nga moshë 15-29 vjeç, në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, përmes ndërhyrjeve në këto shtylla kryesore:

- » KËRKESA PËR PUNË
- » OFERTA PËR AFTËSI
- » KËSHILLIM KARRIERE & NDËRMJETËSIM
- » ÇËSHTJET GJINORE & PËRFSHIRJA SOCIALE

Disa nga arritjet kryesore të RISI ALBANIA në 2023:

ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT DHE KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS

Të ardhura Neto dhe Investime: Arritje prej €831,330 në të ardhura neto shtesë dhe €1,349,288 në investime, duke tejkaluar objektivin. Në veçanti, agrobiznesi kontribuoi me €414,382 në të ardhura neto dhe €845,911 në investime; turizmi gjeneroi €210,430 në të ardhura neto dhe €301,874 në investime; dhe TIK arriti €206,518 në të ardhura neto dhe €201,503 në investime.

Krijimi i Vendeve të Punës: RisiAlbania krijoi 600 vende pune në vitin 2023 në sektorët e agrobiznesit, TIK dhe turizmit.

KËSHILLIMI I KARRIERËS DHE NDËRMJETËSIMI

Shërbime Karriere: U arritën 876 punësime të atribuara ndërmjetësimi dhe këshillimit të karrierës. Partneriteti i rëndësishëm me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ndikoi në rritjen e njoftimeve të punës me 35%, duke ndihmuar në përputhjen më të mirë të punëkërkuarëve me punëdhënësit.

Zgjerimi i Këshillimit të Karrierës: Shërbimet e karrierës u zgjeruan në bashki të reja, duke pajisur qendrat e karrierës me staf të trajnuar në Elbasan, Berat dhe Lushnjë, dhe duke përmirësuar burimet në Qendrën e Karrierës në Tiranë.

AGROBIZNESI

Qasje në Treg dhe Standarde: Me fokus në qasjen në tregjet me vlerë të lartë, RisiAlbania mbështeti përpjekjet për certifikim për eksportuesit e frutave dhe perimeve, që përfshijn tashmë 21 eksportues që arritën standardet GlobalG.A.P. Gjithashtu, iniciativat për eksport të vajit të ullirit përmirësuan ndërgjegjësimin për cilësinë dhe qasjen në tregjet ndërkombëtare.

Angazhimi i Rinisë: Iniciativat për ndërgjegjësimin mbi agrobiznesin synuan të rinjtë shqiptarë, me një fushatë ndërgjegjësimi në shkolla të mesme për të nxitur interesin në agrobiznes.

ZHVILLIMI I TURIZMIT

Turizëm i Qëndrueshëm: Në vitin 2023, RisiAlbania vazhdoi të mbështesë iniciativat për turizëm të qëndrueshëm, përfshirë certifikimin për dy operatorë turistikë shtesë, duke e çuar në pesë numrin total të certifikuar në standardin Travelife.

Partneritete Lokale: Visit Gjirokastra dhe Visit Saranda punuan për forcimin e modeleve të biznesit, kanaleve digjitale dhe partneriteteve rajonale për të diversifikuar shërbimet turistike. Për më tepër, modeli Albergo Diffuso në Krujë mori njohje ligjore si një formë akomodimi në Ligjin për Turizmin, duke mundësuar mbështetje të ardhshme nga qeveria.

SEKTORI TIK

Sigurua Kibernetike dhe Shërbimet Digjitale: RisiAlbania lehtësoi krijimin e vendeve të punës përmes zgjerimit të shërbimeve TIK, veçanërisht në sigurinë kibernetike dhe tregtinë elektronike. Ky sektor kontribuoi në krijimin e 220 vendeve të punës në role digjitale si specialistë të sigurisë IT dhe tregtarë digjitalë.



RisiAlbania

Partner for Growth

<https://www.risialbania.al/>





MBËSHËTJE FINANCIARE

3 SKEMA MBËSHËTËSE

TWIST: Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri



10

Sipërmarrje të mbështetura
(2 sipërmarrje në pronat e konfiskuara nga krimi i organizuar)

22,730,500 Lekë

Vlera totale e mbështetjes financiare

Konkursi i Bizneseve të Gjëlberëta



5

Sipërmarrje të mbështetura

3,263,800 Lekë

Vlera totale e mbështetjes financiare

**Challenge Fund / EU4Innovation
në mbështetje të startupeve inovatore**



1

Thirrje për propozime e hapur gjatë 2023

247

aplikime

{ 117 LOT 1 Faza e idesë dhe validimit
48 LOT 2 Faza e rritjes
82 LOT 3 Faza e zhvillimit





DËSHMI TË PËRFITUESVE TANË

SIPËRMARRËSIT SOCIALË DHE NOVATORË



Një nga përvojat më të rëndësishme ishte vizita në kooperativën sociale "Al di là dei Sogni," e themeluar në një pronë të konfiskuar në rajonin e Casertas. Dëshmia e përfaqësuesit të kooperativës ishte prekje dhe motivuese. Projekti që po zbatohet me TVIST ka ngjashmëri dhe është veçanërisht i vlefshëm në qasjen e tij ndaj trajnimit të individëve me probleme të shëndetit mendor dhe grupeve të marginalizuara.

Të tilla përvoja janë tepër produktive, pasi ato ofrojnë një kuptim të drejtpërdrejtë të funksionimit të sipërmarrjeve sociale dhe zgjidhjeve që ato ofrojnë për të avancuar përpara.

Denada Shpuza Qendra "Hapat e Lehtë", Shkodër

Vizita studimore në sipërmarrjet sociale të ngritura në prona të konfiskuara nga krimi i organizuar në Itali më la një përshtypje të madhe. Takimi zyrtar me z. Bruno Corda, Drejtor i Agjencisë Kombëtare për Administrimin dhe Destinimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nga Krimi i Organizuar në Itali, ishte veçanërisht mbresëlënëse.

Transformimi i një prone të konfiskuar në një hapësirë për argëtimin e të rinjve ishte një mësim i vlefshëm për ne, pasi argëtimi përmes lojës është një pjesë integrale e edukimit të të rinjve. Ekipi foli me pasion për punën e tyre, duke ndarë vështirësitë dhe pengesat që kishin hasur. Përpjekjet e tyre vullnetare ishin vërtet të admirueshme, ashtu si edhe sakrificat që ata bënë përballë kërcënimeve nga kriminelët. Ata theksuan rëndësinë e përfshirjes së grupeve vulnerabël në punësim, duke demonstruar seriozitetin dhe thjeshtësinë në punën e tyre.

Mendoj se kjo vizitë na ofroi njohuri të vlefshme. Të tilla përvoja dhe vizita do të na ndihmonin shumë në punën tonë gjithashtu.

Loreta Mamani MKEZH, Gjirokastrë

Si një sipërmarrëse që gjithmonë kërkon mundësi për të mësuar, për të krijuar eksperiencë të reja dhe për të zgjeruar horizontet, sapo u njoha me projektin EYSET e vlerësova atë si një mundësi të shkëlqyer për t'u përfshirë bashkë me sipërmarrjen time, Dor Arta Handmade që merret me thurjen e qilimave tradicionalë. U përfshiva në projektin EYSET për t'i dhënë Dor Arta mundësinë të prezantohet dhe promovohet në skenën ndërkombëtare.

Seminari online mbi sipërmarrjen sociale, i drejtuar nga profesionistë të fushës, ku na u dha mundësia të prezantim veten dhe biznesin tonë, ishte jashtëzakonisht i vlefshëm dhe interaktiv. Gjithashtu, pjesëmarrja në konkursin me video kreative për prezantimin e sipërmarrjes, ku pata fatin të përzgjidhesha si ndër më të votuarit, më dha mundësinë të merrja pjesë në konferencën finale ISTO në Bruksel, një pikë kulminante për mua si sipërmarrëse. Të dilja jashtë kufijve të Shqipërisë, përballë një audience të madhe ndërkombëtare dhe të promovoja këtë copëz Shqipërie dhe qilimat tanë si produkt turistik, ishte një përvojë e jashtëzakonshme, që më ka frymëzuar dhe motivuar të vazhdoj me më shumë pasion ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Edlira Kurti Sipërmarrëse

Pjesëmarrja ime në programin WISEs4Youth ishte një udhëtim thellësisht pasurues në dijeni dhe përvojë. Kjo periudhë më lejoji të thellohesha në konceptet e sipërmarrjes dhe sipërmarrjes sociale, duke mësuar metoda të reja dhe zhvilluar aftësitë e mia në këtë fushë. Vizita jonë në Kroaci ishte e jashtëzakonshme, duke na dhënë mundësinë të kuptonim realitetin e sipërmarrjes në nivel lokal. Gjatë vizitave studimore në terren, ndamë përvoja dhe histori nga sipërmarrësit lokalë, përfshirë sfidat dhe sukseset e tyre. Kjo përvojë e pasur na ofroi një perspektivë të gjerë dhe arritje të reja, duke kontribuar në rritjen tonë si individë dhe profesionistë në fushën e sipërmarrjes.

Partnerët Shqipëri luajtën një rol vendimtar si një organizator i shkëlqyer gjatë kësaj përvoje. Ata ofruan kujdes të veçantë dhe udhëzime të përshtatshme për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësit të kishin një përvojë të paharrueshme. Informacioni u komunikua në mënyrë efektive dhe efikase, duke mundësuar një kuptim të thellë dhe angazhim të plotë nga pjesëmarrësit gjatë gjithë programit. Kjo kontribuoi në suksesin dhe vlerën e shtuar të kësaj përvoje studimore në fushat e sipërmarrjes dhe zhvillimit personal.

Ulsi Beqiri Student



ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE RRETH SIPËRMARRJES DHE INOVACIONIT SOCIAL



Panairi "The future is Green", për promovimin e bizneseve të mbështetura përmes skemave tona të mbështetjes në fushën e sipërmarrjes, 7 qershor 2023, Kalaja e Tiranës




Dokument politikash:
Përmirësimi i Përfshirjes Sociale dhe në Tregun e Punës të të Rinjve duke Shfrytëzuar Mundësitë e Sipërmarrjes Sociale dhe Burimeve në Fushën e Turizmit (i disponueshëm në anglisht)



Karakteristikat dhe sfidat e sipërmarrjeve sociale në Shqipëri – Studim krahasues



Panairi "The future is Green", organizuar në kuadër të Javës së Gjelbër Evropiane 2023



Aktiviteti "Sipërmarrjet e Gjelbërta dhe Mbështetja e Startupeve në Sektorët e Turizmit dhe Agropërpunimit në Shqipëri", organizuar në kuadër të Javës Globale të Sipërmarrjes (GEW Albania).

Kontribut në agjendën rajonale lidhur me sipërmarrjen sociale




Konferenca e Unionit për Ekonominë Sociale Mesdhetare, mbajtur në 17-18 tetor 2023 në Barcelonë, fokusuar në zhvillimet më të fundit strategjike në nivel evropian të cilat premtojnë për zhvillime në të gjithë rajonin e Mesdheut.



Udhëzues për Sipërmarrësit e Rinj për të Ndërtuar Sipërmarrje Sociale të qëndrueshme - përgatitur në kuadër të WISEs4Youth (i disponueshëm në anglisht)



Paketë mjetesh për të fuqizuar sipërmarrësit e rinj socialë dhe aktorë të tjerë për të replikuar, përshtatur, adoptuar dhe zbatuar mjetet, strategjitë dhe rekomandimet e projektit WISEs4Youth.



Kontribues për Shqipërinë në studimin "Sipërmarrjet Sociale si Partnerë Potencialë në Advokimin për Zhvillimin e Bashkëpunimit" (i disponueshëm në anglisht)

ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE RRETH AKTIVITETIT FILANTROPIK DHE INFRASTRUKTURËS MBËSHTETËSE

Të dhëna rreth Aktivitetit Filantropik



Partnerët Shqipëri kryen monitorimin e përditshëm të aktivitetit filantropik në Shqipëri, dhe prezanton gjetjet në formën e raporteve përmbledhëse për të ndihmuar publikun e interesuar në kuptimin dhe evidentimin e këtij aktiviteti.

PHI
LAN
THR
OPY

"Philanthropy" është një revistë e cila pasqyron çështje të ndryshme rreth nismave dhe zhvillimeve të aktivitetit filantropik në Shqipëri.

Kontribut në agjendën rajonale lidhur me filantropinë



Partnerët Shqipëri është anëtare e WINGS, rrjeti i vetëm global në mbështetje të zhvillimit të filantropisë, i cili shtrihet në 58 vende dhe përbëhet nga një komunitet prej më shumë se 200 aktorësh të ndryshimit, të përkushtuar për të krijuar një mjedis mundësues që filantropia të lulëzojë.



MBËSHTETJE FINANCIARE

AKTIVITETI FILANTROPIK



Rrathë Dhurues është një event i cili mbledh së bashku me një qëllim filantropik, individë nga fusha të ndryshme të cilët vënë në dispozicion ekspertizën, kohën dhe burimet financiare për të mbështetur kauza konkrete që sjellin ndryshime sociale në komunitete të caktuara. Që prej vitit 2018, Partnerët Shqipëri ka organizuar disa evente "Rrathë Dhurues" falë të cilave është mundur mbështetja e nismave komunitare në fushën e edukimit, promovimit të të drejtave të njeriut, aktivizmit rinor, mjedisit dhe turizmit, shërbimeve psiko-sociale për fëmijët në nevojë, përmirësimit dhe krijimit të hapësirave publike për moshën e tretë, etj.

2 EVENTE TË ORGANIZUARA NË 2023

7 NISMA TË MBËSHTETURA NË 2023

88 DHURUES - INDIVIDË DHE BIZNESE

4,818,384 KONTRIBUT I DHURUAR *
Lekë

- **Shërbim i specializuar për 25 fëmijë më aftësi ndryshe, Tiranë**
- **"Të shijojmë natyrën", Librazhd**
- **Rikonceptimi i lulishtes "Marigo Posio", Vlorë**
- **Ngritja e klasës burimore për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta, Bulqizë**
- **Rivitalizimi i "Sheshit Domino", Fushë-Krujë**
- **"E ardhmja për fëmijët", Korçë**
- **Kutia e Periodës së Parë, Shkozë (Tiranë)**

* Vlera i referohet kontributeve monetare, materiale dhe konsulencës falas të ofruar gjatë eventeve



Përmes përfshirjes vullnetare të banorëve, veçanërisht mbi 60 të rinjve, dhe falë mbështetjes bujare prej **26,790** lekë të ofruar nga 12 dhurues në eventin Rrathë Dhurues 2023, 'Sheshi Domino' është tashmë një mjedis i ri dhe kreativ, tërheqës për komunitetin dhe vizitorët.



ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE PËR NJË QEVERISJE TRANSPARENTE DHE TË PËRGJEGJSHME



Eventi përmbyllës i iniciativës “Lëvizja Rinore, një faqe e re për komunitetet lokale”, zbatuar nga Partnerët Shqipëri në kuadër të projektit LevizAlbania. Kuvendi i Shqipërisë, 31 maj 2023




Komente dhe rekomandime lidhur me çështjet që trajton "Udhërrëfytyesi për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike"




Angazhimi dhe dhënia e rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit të Kuvendit të Shqipërisë me organizata të shoqërisë civile dhe gazetarë, për zhvillimin e standardeve dhe treguesve për një parlament të hapur.



Raporti i Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve – 2022



Indeksi i Pjesëmarrjes Rinore – Raporti Rajonal i Monitorimit mbi Pjesëmarrjen Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve 2022 (i disponueshëm në anglisht)



Situata e të rinjve NEET (jo në arsim, punësim, trajnim) në Shqipëri, një analizë krahasuese 2019-2023 (i disponueshëm në anglisht)



Seri tryezash advokuese për ndarjen dhe diskutimin e gjetjeve të Raportit vjetor të Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve

Kontribut në agjendën rajonale rreth çështjeve të qeverisjes transparente



Një seri takimesh në Komisionin Europian, Parlamentin Europian dhe organizata ndërkombëtare në Bruksel, së bashku me partnerët tanë të projektit "Ballkani Perëndimor dhe Turqia për Punësimin Rinor" për të diskutuar mbi përfshirjen politike, ekonomike dhe sociale të të rinjve në nivel vendi dhe rajon.



Workshop rajonal "Bashkëpunimi ndërsektorial për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)", mbajtur në Mal të Zi në 18-22 shtator 2023, organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin (UNODC) në partneritet me Iniciativën Rajonale Kundër Korrupsionit dhe UNCAC.



DËSHMI TË PËRFITUESVE TANË



Duke qenë se ne punojmë me të rinjtë, kishim njohuri se Shqipëria ishte pjesë e rrjetit HUB-i Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, dhe në këtë kuadër e ndiqnim për të parë mundësitë e bashkëpunimit. Falë thirrjes së hapur publike, ne aplikuam, u zgjodhëm dhe u bëmë pjesë e HUB-it, gjë që ishte një ndihmë e jashtëzakonshme për të rinjtë dhe organizatën tonë për të promovuar angazhimin e tyre në nivel kombëtar dhe rajonal. Krahas aspektit financiar, që mundësoi implementimin e projektit, kemi përfituar nga të qenit pjesë e rrjetit, një mundësi e jashtëzakonshme për të shkëmbyer kontakte dhe njohuri me organizatat në Shqipëri dhe rajon.

Saimir Bakalli Fondacioni "Joscelyn", Elbasan

NE KEMI MBËSHTETUR 47 ORGANIZATA NË 5 VENDE TË BALLKANIT PERËNDIMOR



Poster nga fushata e "Javës së Pjesëmarrjes Rinore" organizuar nga rrjeti "HUB-i Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë".



SHËRBIME ME PAGESË

4 KONTRATA SHËRBIMI

39 DITË AKTIVITET




250 PËRFITUES


11 TRAJNIME

24 MENTORIME

Sektori privat
Organizata ndërkombëtare
Organizata lokale



PUNA JONË NË MEDIA





PROJEKTET

PROJEKTI

DONATORI

Demokracia Vendore në Veprim - LEVIZALBANIA	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
Për një treg pune në dobi të rinisë shqiptare - RISI ALBANIA	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri	Bashkimi Evropian
Për një shoqëri civile më të fuqizuar, të adaptueshme dhe të qëndrueshme	Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri
Përmirësimi i Aktivitetit Filantropik dhe Infrastrukturës Mbështetëse në Shqipëri	Rockefeller Brother Funds
TWIST - Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri	Bashkimi Evropian përmes Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri
EU4Innovation, Phase II 2022-2026	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (SIDA) dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
Balkani Perëndimor dhe Turqia për Punësimin Rinor	Komisioni Evropian
RISE - ALB Fuqizimi i sipërmarrjes Sociale në Shqipëri	Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS)
Mundësimi dhe mbrojtja e hapësirës qytetare – Gjetja e zgjidhjeve të reja dhe programeve novatore për adaptimin në hapësirën qytetare në zvogëlim (INSPIRES)	USAID, përmes Partners Global
Vlerësimi i Rrezikut të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
OJF-të shqiptare dhe Rekomandimi 8 i FATF	Human Security Collective (HSC) nën Programin Global të GIZ-it për Flukset e Paligjshme Financiare
Mbrojtja e Hapësirës Qytetare - Hub-i Rajonal për Zhvillimin e Shoqërisë Civile	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (SIDA) përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
Fuqizimi i Organizatave Rinore përmes Sipërmarrjes Sociale në Turizëm (EYSET)	Bashkimi Evropian, Programi Erasmus +
WISEs4Youth në Ballkanin Perëndimor	Bashkimi Evropian, Programi Erasmus +
Korniza e Iniciativave Vendore	Partneriteti i OSHC-ve për Efektivitetin e Zhvillimit (CPDE)
Rrathë Dhurues Shqipëri 2023	The Funding Network
Idetë e Gjellbërta të Ballkanit – Programi i Sipërmarrjes së Gjellbër të Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor	Rockefeller Brother Funds përmes Balkan Green Foundation



MBËSHTETËSIT KRYESORË DHE KONTRAKTORËT TANË



RAPORT VJETOR
2023 2023